


Gjithkush mund të jetë i prekur



**Hepatiti B dhe C...**  
... dhe Ne



Kjo broshurë është fruit i një pune të përbashkët e ndërmerrë nga grupe publike dhe profesionalistësh nën mbikqyrjen e Prométhée, Rrjetit të Hepatitëve në Isëra.

## Falenderojmë të gjithë kontribuesit !

Abdalaouhab, Abdelhakim, Aicha, Alexandre, Anouch, Elisabeth, Fatima, Fitim, Iulia, Jaspal, Kanga, Lukaki-Lady, Magrîbe, Marie, Nsaadine, Marine, Orzhen, Paruine, Pratiina, Rudi, Shadi, Shkumbim, Spartak, Taulant, Valon, Wejdi, Yeseda, Zefina, ...

### Profesionelët e grupit të punës dhe të komitetit drejtues

Denise Bezet (IDE, le CADA LPN), Marc Bréssan (coordinateur DDPS), Gaëlle Dubrac (coordinatrice CDRPVH), Dr Bruno Froissart (HGE Ibérol), Nathalie Hannhart (psychologue de la prévention, Prométhée), Dr Marie-Noëlle Hilleret (PH, CHU Grenoble), Messaouda Abdjila-Kheïlat (animatrice socio-éducative, CADA le Cédre), Elhadji M'Baye (sociologue, CRSPERE/Sondara), Hélène Mollard (assistante, Prométhée), Nathalie Muller (IDE, CHU Grenoble), Pascal Pourtau (coordinateur, CRIPS), Jonathan Quard (chargé de prévention, ADES), Saadia Salsaf (IDE, DDTI), Thierry Trilles (coordinateur ADES) et Simon (élève IDE, DDTI).

### Perkthyesit vullnetare të ADATE-s dhe të EPU

Mehribane Elbasani, Maximilien Pofelski, Jessica Hawkins, Fares Gaedidh, Achot Akopian, Zrinka Radic, Juliette Lalanne, Václav Capek, Karine Moura, Irina Rafaeelyan, Paolo Fonti, Angela Lemma, Tatiana Badin, Battulga Enkhbayar, Rahim Ebrahim, Joanna Pofelski, Abinon Siqueira, Aurora Talu, Christina Moreva, Phongsab Montiya, Sercan Genc. Mbikqyrësit e grupeve dhe strukturat që na hapën dyert e tyre : Adoma, Asstam, CADA le Cédre, Centre social les Essarts, MJC Albaye.

Koordinatorët : Laurence Lianet

## Pse të flasim për hepatitin B dhe C ?

Sepse janë sëmundje



Të cilat **nuk dallohen në pamje të parë** . . . faqe 4



Të cilat janë **të shpeshta** . . . . . faqe 6




Të cilat mund të jenë **të rënda** . . . . . faqe 8



Të cilat janë **ngjitëse** . . . . . faqe 12



Të cilat mund t'i **shmangim** . . faqe 12



Të cilat mund t'i **shërojmë** . . . . . faqe 22





Të cilat mund t'i **zbulojmë** . faqe 24


# Cfarë është një hepatit ?



Hepatiti është një ndezje (inflamacion) e mëlçisë



Foie normal



Foie inflammé


Mëlçia është një **organ jetik**

Ajo shërben për grumbullimin, transformimin, fabrikimin të shumë elementeve thelbësore për funksionimin e trupit dhe për eliminimin e substancave toksike


Hepatiti mund të shkaktohet nga elemente toksike si : alkooli, ilaçet, kërpurdhërat..., ose **viruset**.



Hepatiti B dhe C janë hepatite virale, dmth që shkaktohen nga viruset.



Virusi i hepatitit B



Virusi i hepatitit C

# Cilat janë shenjat e një hepatiti B ose C ?


?

Në të shumtën e rasteve nuk ka simptome të veçanta.



Nuk ndihemi të sëmurë.  
Nuk e dimë që jemi të sëmurë.



Në disa raste, në fillim të infeksionit, mund të dallojmë zverdhje, të përshtjella, dhimbje, lodhje




dhe lodhja mund të zgjasë.



E vetmja mënyrë për të zbuluar nëse kemi hepatitin B ose C është **ekzaminimi** (analiza). (shih faqen 23)



# Hepatitet B dhe C: sëmundje të zakonshme ?




Hepatiti B dhe C janë sëmundje të zakonshme.


Në të shumtën e rasteve, personat që kanë hepatitin B ose C **nuk e dinë që janë të semurë**

## Në botë...

1 person ndër 3 ka qenë në kontakt me virusin B ose C.



1 person ndër 12 ka një hepatit kronik B ose C.






# A është i rrezikshëm hepatiti B ?



Në botë...



**Kontakt**  
me virusin



2 miliard

10%


## Hepatit kronik:

Virusi qëndron në  
mëlçi dhe vazhdon të  
shumëfishohet



1%

**Hepatit fulminant (vdekjeprurës) :**  
Virusi shkatërron plotësisht mëlçinë



89%


## Shërimi :

Virusi eliminohet nga  
organizmi




Zhvillime pa trajtim 20 deri 30 vjet


## Fibrozë



**Cirrozë**  
(20 - 40%)



## Kancer



600 000 të vdekur në vit

80%








# A është i rrezikshëm hepatiti C ?



Në botë...



**Kontakt**  
me virusin



200 million

80%

## Hepatit kronik :

Virusi qëndron në  
mëlçi dhe vazhdon të  
shumëfishohet



20%


## Shërimi :

Virusi eliminohet nga  
organizmi




Zhvillime pa trajtim 20 deri 30 vjet


## Fibrozë



## Cirrozë (20 - 40%)



## Kancer




350 000 të vdekur / vit





## Si përhapet hepatiti B dhe C ?

Nga nëna shtatzënë tek bebja gjatë shtatzanisë ose gjatë lindjes kur nëna është kontaminuar me këtë virus.



## – Si mund të shmangim përhapjen e virusit ?



Kur nëna ka hepatitin B, i bëjmë një vaksinë speciale bebes fill pas lindjes për ta mbrojtur : ( **sero-vaksina** ).



Kundër hepatitit C, **nuk ka sero-vaksinë**, por edhe rreziku i përhapjes nga nëna tek bebja është shumë i vogël.




## – Si mund të shmangim përhapjen e virusit ? Duke bërë vaksinën.



Ekziston **një vaksinë** për bebet, fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit, që reagon jashtzakonisht mirë kundër hepatitit B.

Kur jemi të vaksinuar kundër hepatitit B nuk ka më asnjë rrezik që të marrësh apo përhapësh këtë sëmundje.



## Ku mund të vaksinohemi?

- Tek mjeku
- Në një qendër vaksinimi falas.



**Nuk ekziston asnjë vaksinë** kundër hepatitit C.







## Si përhapet hepatiti B dhe C ?



Nëpërmjet marrdhënieve seksuale pa prezervativ me një person të infektuar: Me anë të seksit, anus-it, gojës, në mes një mashkulli dhe një femre, por edhe ndërmjet njerëzve të të njëjtit seks.



Shumfishimi i partënerëve seksual rrit rrezikun e infektimit.




Virusi C nuk përhapet nga lëngjet seksuale, por ekziston një rrezik nëse gjatë marrdhenieve kemi **kontakt me gjakun** : në periudhën e rregullave, në rast të një plage ose një raporti traumatik.



## – Si mund të shmangim përhapjen e virusit ?



- Duke përdorur një **perzervativ** për meshkuj ose femra




- Si dhe **lubrifikante** për të limituar rrezikun e plajës së perzervativit apo lezioneve.



## Si përhapet hepatiti B dhe C ?

Gjatë vizitave mjeksore në disa vende të ndryshme të botës dhe në Francë para vitit 1992 : Transfuzionit të gjakut, operacioneve të vështira, reanimacionit, shërbimeve mjeksore me material të pa sterilizuar.

Nëpërmjet gjakut




Përdorimi i përbashkët i **mjeteve tualetore** që janë në kontakt me gjakun



## – Si mund të shmangim përhapjen e virusit ?



Duke kërkuar gjithmonë **material një përdorimsh.**



Duke përdorur mjetet **personale** të tualetit.






## Si përhapet hepatiti B dhe C ?

**Bashkpërdorimi i materialeve që kanë të bëjnë me përdorimin e drogës :** sheringat, pambukun, filtrat, lugët, ose çubukun e krakut...



Nëpërmjet gjakut



**Gjatë tatuimit, persingut, incizioneve...** me një material që ka shërbyer për të tjerët : gjilpëra, boja, bizhuteritë...



## – Si mund të shmangim përhapjen e virusit ?



Nëse drogohemi, duke përdorur **material te ri dhe personal**



Duke shkuar tek një **profesional** që përdor materiale sterile



# Nuk ka rrezik transmetimi të



Në fakt ekziston një rrezik shumë i vogël i transmetimit të hepatitit B me atë të puthjeve të thella.


# Cfarë të bëjmë nëse kemi një hepatit B apo C ?



Ekzistojnë disa lloje **trajtimesh**



Trajtimi nuk të shëron nga hepatiti B, por ndihmon në ndalimin e shumëfishimit të virusit dhe të krijon mindësinë të jetosh normalisht.



Trajtimi kundër hepatitit C të shëron në të shumtën e rasteve

Kur jemi të sëmurë është e **rëndësishme** :

- Të mos ndërpresësh kurën para kohës se caktuar nga mjekët
- Të vizitohesh rregullisht tek mjeku gjatë të gjithë kohës deri në shërim
- Të flitni në rrethin tuaj në menyre që të ndihmoheni në rast vështirësish.



- Të mos **pish** alkool, kanabis, duhan, apo të ngresh sende të rënda të cilat ndikojnë në zhvillimin e sëmundjes.






# Si t'a dimë që kemi një hepatit B ose C ?




## Duke bërë një depistim

Që është një kontroll special për të kërkuar nëse virusi është në trup apo jo.  
Për t'u siguruar që nuk jemi të sëmurë apo për t'u shërur para se të jemi shumë të sëmurë dhe për të mbrojtur familjen dhe të afërmit.

**Depistim i zakonshëm :**  
Marrje gjaku (2 ditë)



**Depistim i shpejtë :** Marrje e gjakut në majë të gishtit (20 minuta)



\* Nëse testi është pozitiv, duhet bërë një analizë gjaku për të qenë të sigurtë për rezultatin.

## Ku te depistohemi?

- Me një recetë të mjekut, në një laborator analizash
- Pa recetë të mjekut, në një qendër depistimi anonime dhe falas (CDAG)
- Në disa shoqata



24



Një depistim negativ nuk do të thotë që jeni të mbrojtur nga sëmundja. Virus mund të transmetohet në çdo kohë nëse rrezikojmë.



25




# Po hepatitet e tjera virale ?

Ata janë më të rralla dhe më pak të dëmshme

Në disa raste mund të kemi disa hepatite në të njëjtën kohë, gjë e cila

rrit rrezikun e komplikacioneve të ndryshme.



|                           |  | Hepatit A                                                                                                   | Hepatit D                                                                                                                      | Hepatit E                                                                  |
|---------------------------|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| Rastet e vdekjeve në botë |  | 1,4 milion raste/vit<br>7 000 vdekje/vit<br>Rrallë në Francë                                                | Merret në të njëjtën kohë ose mbas një hepatiti B.<br>Virusi D përdor virusin B për tu shtuar.<br>10 milion të sëmurë kronikë. | 20 milion raste në vit<br>70 000 vdekje në vit<br>Shumë i rrallë në Francë |
| Transmetimi               |  | Përmes rrugëve fekal-orale dmth me anë të ujit dhe ushqimeve të ndotura (në mungesë të ujit të pijshëm)<br> |                                                                                                                                | Nga mishi i dërrit të infektuar<br>Uji apo ushqimet e ndotura<br>          |
| Evolucioni                |  | Shërim spontan në rreth 99% të rasteve<br><br>Hepatit fulminant (vdekjeprurës) në 1% të rasteve             | Shërim 20%<br><br>Hepatit kronik 80%                                                                                           | Shërim 99%<br><br>Hepatit fulminant 1%                                     |
| Trajtimi                  |  |                                                                                                             |                                                                                                                                |                                                                            |
| Parandalimi               |  |                                                                                                             |                                                                                                                                |                                                                            |



Avec le soutien financier de la DGS

